

**URDHËR**  
**Nr. 9, datë 5.2.2019**

**PËR PJESËMARRJEN E PËRFAQËSUESVE TË INSPEKTORATIT QENDROR NË  
PROCESET GJYQËSORE ME OBJEKT GJYKIMI VEPRIMTARINË INSPEKTUESE  
TË INSPEKTORATEVE SHTETËRORE**

Në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për inspektimin dhe ligjeve të posaçme, në kryerjen e procedimit administrativ të inspektimit;

**URDHËROJ:**

1. Inspektoratin Qendror, si organ publik, të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ të ankimuar, si palë në proceset gjyqësore.
2. Mbështetjen e inspektorateve shtetërore/ trupave inspektuese, me përfaqësues nga Sektori Juridik i Inspektoratit Qendror, në proceset gjyqësore me objekt gjykimi ankimit të subjekteve inspektuese ndaj vendimit përfundimtar të Trupës Kolegjiale të Ankimit të inspektorateve shtetërore/trupave inspektuese.
3. Përfaqësuesit e Inspektoratit Qendror, për të gjitha rastet që do të jenë pjesë e kësaj procedure gjykimi, duhet të jenë të autorizuar, si dhe të njihen paraprakisht me dosjen e inspektimit.
4. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të Inspektoratit Qendror dhe Inspektorateve Shtetërore/trupave inspektuese për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror [www.insq.gov.al](http://www.insq.gov.al), si dhe iu njoftohet inspektorateve shtetërore/trupave inspektuese.  
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Shkëlqim Hajdari**